

Vendim nr. 197 datë 16.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 16.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (H) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

KËRKUES: HASAN ROQI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 7757, datë 26.12.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 1188 86-2017-1183, datë 23.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-5304, datë 24.12.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nr. 35007-00101-00-2025 akti, caktuar për shqyrtim në datën 03.06.2025 nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pas kërkesës së datës 12.02.2025 të kërkuarit, me objekt “Për sqarim, interpretim dhe ndreqje të gabimeve në arsyetimin e vendimit nr. 00-2024-5304, datë 24.12.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë”; nr. 193, datë 23.05.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2025-281, datë 30.01.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe nr. 00-2025-241, datë 30.01.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi për rigjykim në shkallë të parë, brenda afateve të shkurtra ligjore, të përcaktuara nga Gjykata Kushtetuese, për rehabilitimin dhe zhdëmtimin në përputhje me ligjin e

kohës, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 21.06.1993, vendimin përfundimtar nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, lënë në fuqi nga vendimi nr. 76, datë 08.11.2000 i Gjykatës Kushtetuese për të drejtat e kërkuarit dhe të familjes së tij, sipas nenit 44 të Kushtetutës të shkelura nga veprimet e paligjshme të administratës dhe gjykatave të ligjit.

BAZA LIGJORE:

Nenet 4, pikat 1, 2 dhe 3, 5, 7, 11, pika 2, 15, pikat 1 dhe 2, 17, pikat 1 dhe 2, 18, pikat 1, 2 dhe 3, 25, 37, pika 1, 41, pikat 1 dhe 2, 42, pikat 1 dhe 2, 44, 81, pika 2, shkronjat “a” dhe “d”, 100, pikat 4 dhe 5, 107, pika 1, 116, pika 1, shkronjat “a”, “c” dhe “ç”, 117, pika 1, 118, pikat 1 dhe 2, 122, pika 2, 124, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f”, 132, pikat 1 dhe 2, 134, pika 1, shkronja “i”, pika 2, 141, pikat 1 dhe 2, 142, pikat 1 dhe 3, si dhe 145, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6.1, 8.1, 13, 14, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 1, pika 2, 26, pikat 1 dhe 2, 27, pikat 1, 2 dhe 3, 36, 37, 39, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, 43/b, pikat 1 dhe 2, 48, pikat 1 dhe 2, 49, pika 3, shkronja “e” dhe 4, 50, pika 4, 71, 71/a, pikat 1 dhe 2, 71/ç, pikat 1, 2, 3 dhe 4, 72, pika 7, 76, pikat 1 dhe 3, 81, pikat 1, 2, 3 dhe 4, të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është i biri i të ndjerit S.R., i cili nga viti 1989 ka banuar si qiramarrës kryesor në një banesë në qytetin e Tiranës, në të cilën ka bërë disa shtesa anësore. Me vendimin nr. 314, datë 11.04.1994 (*vendimi nr. 314/1994*), Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP), Tiranë ka miratuar kërkesën e ish-pronarit Xh.K. për kthimin e banesës dykatëshe dhe disa ambienteve të tjera në oborrin e saj, duke përcaktuar se vlera e shpenzimeve të shtesës anësore të ndërtuar nga babai i kërkuesit përbën 11,7% të vlerës së banesës, pra është nën 20%, ndaj kjo shtesë i kthehet ish-pronarit Xh.K pa kundërshtim, mbështetur në nenin 3 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” (*ligji nr.7698/1993*). Pas ankimit të këtij vendimi nga babai i kërkuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1666, datë 16.04.1997, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, vendim i cili është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 2227, datë 08.10.1997, në të cilin vlera e shpenzimeve është njohur në masën 37%, që përkonte me vlerën 286,890 lekë të kontributit të tij në pjesën që përdorte në raport me ndërtesën e ish-pronarit. Gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të KKKP-së, Tiranë për pjesët e tjera. Ky vendim i gjykatës së apelit është lënë në fuqi nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 489, datë 26.03.1998. Me vendimin nr. 17, datë 09.02.2000, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga S.R.

2. Shtetasi S.R. i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve të mësipërme, e cila, me vendimin nr. 76, datë 08.11.2000 (*vendimi nr.76/2000*), ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar se nuk ndodhej para një procesi të parregullt ligjor dhe se pretendimet e kërkuesit ishin të natyrës ligjore dhe jo kushtetuese.

3. Në vijim, S.R. ka bërë kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 2024, datë 20.11.2007. Më tej, në datën 19.09.2008, ai ka kërkuar nga Zyra e Përmbarimit Shtetëror Tiranë ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor titull ekzekutiv, konkretisht regjistrimin e tij si bashkëpronar të banesës në bazë të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 21.06.1993 (*udhëzimi nr. 3/1993*), dalë në zbatim të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, për sa kohë vlera e

ndryshimeve në shtesat anësore të banesës, sipas vendimit gjyqësor, ka rezultuar 20-50%, ndërkohë që ish-pronari nuk ka paguar brenda një viti detyrimin për to. Pas një korrespondence me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Tiranë, në datën 24.02.2009 përmbaruesi gjyqësor ka refuzuar kryerjen e veprimeve përmbarimore, me arsyetimin se vendimi gjyqësor ishte i paqartë dhe kreditori S.R. duhet të bënte sqarimin dhe interpretimin e tij, ndërkohë që përmbaruesi gjyqësor nuk mund të dilte jashtë kompetencave ligjore për ekzekutimin e vendimit gjyqësor sipas pjesës urdhëruese të tij.

4. Nga ana tjetër, në datën 22.05.2009, me kërkesë të një prej trashëgimtarëve të ish-pronarit Xh.K., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar sërish urdhrin e ekzekutimit për vendimin nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Më pas, trashëgimtari i ish-pronarit Xh.K. ka kërkuar nga Zyra e Përmbarimit Shtetëror Tiranë ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor titull ekzekutiv. Përmbaruesi gjyqësor ka mbajtur të njëjtin qëndrim, duke refuzuar ekzekutimin me të njëjtin arsyetim, me orientimin që palët t'i drejtohen gjykatës për sqarimin dhe interpretimin e vendimit, për sa kohë që në të nuk përcaktohej ndonjë detyrim i shprehur që duhej të përmbushej.

5. Në këto kushte, trashëgimtari i ish-pronarit Xh.K. i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë për interpretimin e vendimit të saj nr. 2227, datë 08.10.1997. Për këtë kërkesë, me vendimin nr. 28, datë 02.03.2010, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur rrëzimin e saj, me arsyetimin se vendimi është i qartë për sa i përket vlerës së punimeve të pretenduara nga paditësi S.R, që, në rastin konkret, konsiderohet si detyrim për t'u përmbushur nga palët e paditura, trashëgimtarët e ish-pronarit Xh.K.

6. Pas këtij vendimi gjyqësor, trashëgimtarët e ish-pronarit Xh.K., në datën 29.03.2010 kanë derdhur në llogarinë bankare të Zyrës së Përmbarimit Shtetëror Tiranë vlerën 286,890 lekë në favor të shtetasit S.R. Më tej, në datën 20.04.2010 ZVRPP-ja, Tiranë ka lëshuar në favor të trashëgimtarëve të ish-pronarit certifikatën e vërtetimit të pronësisë për pasurinë “ndërtesë dhe truall”.

7. Nga ana tjetër, në funksion të kërkesës së shtetasit S.R., përmbaruesi gjyqësor i ka dërguar ZVRPP-së, Tiranë vendimin gjyqësor interpretues si më lart. Po kështu, S.R. i është drejtuar edhe vetë ZVRPP-së, Tiranë për regjistrimin e vendimit nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, pra për regjistrimin e tij si bashkëpronar mbi argumentin e përshkruar në paragrafin 3 të këtij vendimi. ZVRPP-ja, Tiranë, me shkresat e datave 20.07.2010, 18.10.2010

dhe 27.10.2010, i ka kthyer përgjigje S.R., duke i bërë të ditur se kërkesa e tij për regjistrimin e vendimit nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë ishte e pambështetur, pasi në emrin e tij nuk rezultonte asnjë pasuri e regjistruar dhe se pranë saj nuk ishte depozituar asnjë vendim gjykate që përbënte titull pronësie në favor të tij. Sipas ZVRPP-së, Tiranë, vendimi nr. 2227, datë 08.10.1997 i Gjykatës së Apelit Tiranë nuk anulonte vendimin nr. 314/1994 të KKKP-së, por njihte vetëm shtesat anësore të bëra në vlerën 37% të kontributit, vlerë për të cilën S.R. ishte kundërshtpërblyer nga ish-pronari Xh.K., sipas ligjit, ku mbi këtë bazë, pas depozitimit të dokumentacionit përkatës, për trashëgimtarët e këtij të fundit ishte lëshuar edhe certifikata për vërtetim pronësie.

8. Ndërkohë, pas pajisjes me certifikatën e pronësisë, dy nga trashëgimtarët e ish-pronarit Xh.K. kanë paraqitur padi me objekt “lirim dhe dorëzim sendi” kundër S.R. dhe familjarëve të tij, ndër ta edhe kërkuesi. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 9405, datë 09.12.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e të paditurve, Hasan Roqi etj., të lirojnë dhe t’u dorëzojnë paditësve ambientet e banimit që posedojnë në shtëpinë e banimit pronë e paditësve. Ky vendim, pas ankimit të të paditurve Roqi, është lënë në fuqi me vendimin nr. 2029, datë 06.10.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Me vendimin nr. 00-2014-1736, datë 04.07.2014, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të të paditurve Roqi.

9. Më tej, S.R. ka paraqitur padi me objekt konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të vendimit nr. 314/1994 të KKKP-së, Tiranë, në favor të trashëgimlënësit të të paditurve, Xh.K., padi e cila është rrëzuar nga vendimet nr. 8996, datë 03.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. 2610, datë 10.12.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe për të cilën Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1709, datë 11.04.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit.

10. Ndërkohë që çështja ishte në gjykim, S.R. dhe trashëgimtarët e tij, me kërkesat e datave 31.07.2012 dhe 23.08.2012, i janë drejtuar ZVRPP-së, Tiranë dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP), respektivisht, për revokimin dhe shfuqizimin e certifikatës së pronësisë të datës 20.04.2010, por pa marrë përgjigje.

11. Në vijim, në datën 26.10.2012 paditësit Roqi i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi kundër ZVRPP-së, Tiranë, ZQRPP-së, Tiranë, person i tretë F.K. dhe Zyra e Përmbaramit Shtetëror, me objekt: “Anulimin e aktit administrativ, certifikatë vërtetim

pronësie e datës 20.04.2010, në emër të trashëgimtarëve të ish-pronarit Xh.K., lëshuar nga ZVRPP-ja, Tiranë, në kundërshtim me ligjin, duke i kthyer palët në gjendjen e mëparshme; detyrimin e ZVRPP-së, Tiranë të lëshojë certifikatën e pronësisë për këtë pasuri në bashkëpronësi, në raportet 37% në emër të S.R. dhe familjarëve të tij, në bazë të vendimit 314/1994 të KKKP-së Tiranë, të ndryshuar me vendimin e formës së prerë nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 489, datë 26.03.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe vendimi nr.76/2000 të Gjykatës Kushtetuese, të detyrueshme për ekzekutim, nga urdhri i ekzekutimit nr. 2024, datë 20.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe nga vendimi nr.28, datë 02.03.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

12. Me vendimin nr. 9393, datë 23.09.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes për shkak mosparaqitjeje. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 64, datë 04.02.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të pushimit të shkallës së parë dhe kthimin për rigjykim të çështjes në të njëjtën gjykatë me trup tjetër gjykues. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.7985, datë 22.10.2015, ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, e cila, me vendimin nr. 2998 80-2016-2996, datë 13.06.2016, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, konstatimin e pavlefshmërisë së veprimit administrativ të ZVRPP-së, Tiranë, për lëshimin e certifikatës së pronësisë së datës 20.04.2010 në emër të personave të tretë si një akt në tejkalim të kompetencave të parashikuara me ligj, si dhe shfuqizimin e veprimeve administrative të ZVRPP-së për ndarjen e sipërfaqes së përgjithshme të truallit në dy sipërfaqe dhe konstatimin e paligjshmërisë për lëshimin e certifikatave të pronësisë. Mbi ankimin e ZQRPP-së dhe ZVRPP-së, Dega Vendore Tiranë, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 106 (86-2023-137), datë 07.02.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë.

13. Ndërkohë, në datën 01.09.2014, S.R. dhe trashëgimtarët e tij i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) , Dega Vendore Tiranë (ish-Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë), me objekt: (i) pavlefshmëri absolute e aktit administrativ, certifikatë vërtetim pronësie e datës 20.04.2010, të lëshuar nga ZVRPP-ja, Tiranë, në kundërshtim flagrant me ligjin, me vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe me urdhrin e Zyrës Përmbarimore Tiranë; (ii) detyrimin e ZVRPP-së, Tiranë dhe ZQRPP-së të shpallin absolutisht të pavlefshëm dhe të fshijnë nga regjistri hipotekar regjistrimin e paligjshëm të pasurisë në emër të trashëgimtarëve; ZVRPP-

ja, Tiranë dhe ZQRPP-ja të shpallin absolutisht të pavlefshme certifikatën e datës 20.04.2010, të bëjnë regjistrimin e pasurisë, të pjesës në bashkëpronësi, në raportet 37% në emër të S.R. dhe familjarëve të tij dhe 63% në emër të trashëgimtarëve të ish-pronarit Xh.K; të lëshojnë certifikatë për vërtetim pronësie për bashkëpronësinë, në bazë të vendimit nr. 314/1994 të KKKP-së, Tiranë, që përbën urdhër ekzekutiv drejtpërdrejt të regjistrueshëm në ZVRPP-në, Tiranë, pika e dytë e të cilit u ndryshua me vendimin e formës së prerë nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; (iii) detyrimi i ZVRPP-së, Tiranë dhe ZQRPP-së të shpërblejnë dëmin moral në shumën minimale 5.000.000 lekë për secilin nga 6 anëtarët e familjes së S.R., dëmin material, ku të përfshihen qiratë e 3 vjetëve të banesës aktuale në të cilën banon familja Roqi, në shumën 900.000 lekë, fitimi i munguar dhe kamatëvonesat.

14. Me vendimin nr.7757, datë 26.12.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pushimin për dy kërkimet e para të objektit të padisë, me arsyetimin se ka të njëjtin objekt, palë ndërgjyqëse e shkak me objektin e vendimit nr. 9393, datë 23.09.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim S.R. dhe trashëgimtarët e tij.

15. Me vendimin nr. 1188 86-2017-1183, datë 23.03.2017, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë, pasi është rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor të zhvilluar në respektim të dispozitave procedurale dhe është marrë në zbatim të drejtë të ligjit material në raport me faktet dhe provat objekt gjykimi. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs S.R. dhe trashëgimtarët e tij.

16. Në datën 12.04.2017 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë për sqarim, interpretim, ndreqje gabimesh dhe plotësim të vendimit nr. 1188 86-2017-1183, datë 23.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit në pjesën hyrëse dhe arsyetimin e tij. Me vendimin nr. 193, datë 23.05.2017, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës për ndreqje gabimesh dhe pasaktësish dhe rrëzimin për kërkimet e tjera të padisë. Kundër këtij vendimi në datën 11.09.2017 kanë paraqitur rekurs S.R. dhe trashëgimtarët e tij.

17. Në datën 25.10.2024 gjyqtarja E.M.(S) ka bërë kërkesë për heqje dorë nga gjykimi i çështjes së themelit në Gjykatën e Lartë, me objekt shpërblimin e dëmit, me arsyetimin se kishte shfaqur mendim për veprimtarinë e paligjshme të ASHK-së lidhur me zbatimin e gabuar të vendimit nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Me vendimin nr. 461, datë

04.11.2024, kryetari i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës me arsyetimin se nuk konstatohet shfaqje e njëanshmërisë së saj, pasi çështja për të cilën ka dhënë mendim nuk lidhet me çështjen e dëmshpërblimit.

18. Në datën 19.11.2024 kërkuesi i drejtohet kryetarit të Gjykatës së Lartë me kërkesë për bashkimin e katër çështjeve të tij, të cilat kanë në objekt mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë nr. 2227, datë 08.10.1997, por nuk merr përgjigje.

19. Me vendimin nr. 00-2024-5304, datë 24.12.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit ndaj vendimit nr. 1188 86-2017-1183, datë 23.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

20. Më tej, kërkuesi në datën 29.01.2025 i është drejtuar Gjykatës së Lartë për përjashtimin e gjyqtarëve E.M. (S), A.A. dhe G.M. nga trupi gjykues i shortuar për gjykimin e çështjes me objekt: “Ndreqje gabimi, plotësim vendimi dhe sqarim e interpretim i vendimit nr.1188, datë 23.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit”. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-241, datë 30.01.2025, ka rrëzuar kërkesën me arsyetimin se fakti që trupa e gjyqtarëve ka marrë në shqyrtim çështje të tjera administrative të regjistruara në Gjykatën e Lartë, që i përkasin kërkuetit dhe familjarëve të tij, përjashton mungesën e paanshmërisë në raport me gjykimin e çështjes për të cilën kërkohet përjashtimi i gjyqtarëve, e cila ka në objekt ndreqjen e gabimit, plotësimin e vendimit, sqarimin dhe interpretimin e vendimit nr.1188, datë 23.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit. Në të njëjtën ditë, me vendimin nr. 00-2025-281, datë 30.01.2025, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit për sqarim, interpretim dhe ndreqje gabimesh, si dhe plotësim të vendimit nr. 1188 86-2017-1183, datë 23.03.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit.

21. Në datën 12.02.2025 kërkuesi i është drejtuar kryetarit të Gjykatës së Lartë me kërkesë për sqarim interpretim dhe ndreqje gabimesh në arsyetimin e vendimit nr. 00-2024-5304, datë 24.12.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (çështja e themelit), ndërsa në datën 16.04.2025 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës së Lartë me kërkesë për sqarim, interpretim dhe ndreqje gabimesh në arsyetimin e vendimit nr. 00-2025-281, datë 30.01.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

22. Në datën 03.06.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Në datën 17.06.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me një kërkesë tjetër për shtim të objektit të ankimit kushtetues: “Shfuqizimi i vendimeve nr. 193, datë 23.05.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2025-281, datë 30.01.2025 të Kolegjit Administrativ dhe nr. 00-2025-241, datë 30.01.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuetit

23. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

23.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

23.1.1. *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi kryetari i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 461, datë 04.11.2024, ka refuzuar kërkesën për vetëpërfjashtim të gjyqtarës E.M. (S), e cila ka marrë pjesë në vendimmarrje diametralisht të kundërta, sikurse vendimi nr.106, datë 07.02.2023 i Gjykatës Administrative të Apelit që shfuqizon certifikatën e pronësisë për trashëgimtarët e ish-pronarit Xh.K. të datës 20.04.2010, lëshuar nga ASHK-ja, ndërkohë me vendimet nr. 00-2024-5304, datë 24.12.2024 dhe nr. 00-2025-281, datë 30.01.2025 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i vlerëson të ligjshme veprimet e ASHK-së. Me vendimin nr .00-2025-241, datë 30.01.2025, gjyqtari i vetëm, në emër të Kolegjit Administrativ, vendosi rrëzimin e kërkesës për përfjashtimin e Kolegjit Administrativ të përbërë nga gjyqtarët E.M. (S), A.A. dhe G.M., të shortuar për gjykimin e çështjes me objekt: “Ndreqje gabimi, plotësim vendimi dhe sqarim e interpretim të vendimit nr.1188, datë 23.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit”.

23.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat e faktit dhe Kolegji Administrativ nuk kanë paraqitur në arsyetimin e tyre një ligj tjetër material që të ketë ndryshuar udhëzimin nr. 3/1993, dalë në zbatim të ligjit nr.7698/1993, sipas së cilit kur vlera e ndryshimeve del 20-50 %, diferenca mbi 20% paguhet nga ish-pronari brenda 1 viti, në të kundërt objekti mbetet në bashkëpronësi, ndërkohë që ish-pronari nuk ka paguar brenda një viti detyrimin për shtesat anësore të banesës ose vendime gjyqësore të mëparshme të cilat të kenë rrëzuar vendimin nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, lënë në fuqi nga vendimi nr. 489, datë 26.03.1998 i Gjykatës së Kasacionit, lënë në fuqi nga vendimi nr. S-17, datë 09.02.2000 i Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë, lënë në fuqi nga vendimi nr. 76/2000 i Gjykatës Kushtetuese, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 38/2000, për të cilat ka dalë vendimi i urdhrit të ekzekutimit nr. 2024 akti, datë 20.11.2007 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e shkallës së parë e ka konsideruar të njëjtë padinë e ngritur për pavlefshmërinë absolute të certifikatës së pronësisë dhe shpërblimin e dëmit në këtë gjykim me padinë për pavlefshmëri relative të ngritur në një gjykim tjetër, duke sjellë si pasojë pushimin e kërkesave të kërkuarit për pavlefshmëri absolute, si dhe e ka lënë pa shkak ligjor kërkimin e tretë të padisë, duke hequr konstatimin e veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme të ASHK-së. Ndërkohë, gjykata e apelit nuk përmend në arsyetimin e saj kërkimet e tjera të padisë për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të certifikatës së pronësisë të paraqitur nga kërkuari në nisje të procesit gjyqësor. Kryetari i Gjykatës së Lartë nuk u ka kthyer përgjigje kërkesave të kërkuarit të datave 11.09.2023 dhe 28.09.2024 për bashkimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë në mbrojtje të vendimit nr. 76/2000 të Gjykatës Kushtetuese. Kërkesa i është drejtuar edhe trupit gjykues të Gjykatës së Lartë në datën 19.11.2024, por nuk i është dhënë përgjigje.

23.2. *E drejta për dëmshpërblim si rezultat i veprimeve të padrejta të gjykatave.*

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

24. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht, për pasojë mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

25. Kolegji vlerëson se kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është trashëgimtar ligjor i babait të ndjerë S.R., i cili ka qenë palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

26. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim individual kushtetues, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018; nr. 31, datë 25.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

27. Në rastin konkret, objekt i ankimit kushtetues individual, ndër të tjera, është çështja nr. 35007-00101-00-2025 akti, caktuar për shqyrtim në datën 29.05.2025 nga Kolegji Administrativ i

Gjykatës së Lartë, pas kërkesës së datës 12.02.2025 të kërkuarit, me objekt “Për sqarim, interpretim dhe ndreqje të gabimeve në arsyetimin e vendimit nr. 00-2024-5304, datë 24.12.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë”. Nga të dhënat e marra nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë ka rezultuar se çështja në fjalë është planifikuar për shqyrtim fillimisht në datën 30.04.2025, është shtyrë në datën 14.05.2025 dhe është shqyrtuar më pas në datën 29.05.2025, ndërkohë që vendimi nuk rezulton të jetë publikuar në faqen zyrtare dhe as të jetë bërë i disponueshëm për palët, për rrjedhojë lidhur me vendimin për sqarim, interpretim dhe ndreqje të gabimeve në arsyetimin e vendimit nr. 00-2024-5304, datë 24.12.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, Kolegji vlerëson se kërkuari nuk e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000.

28. Lidhur me kërkimet e tjera, kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

29. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor, mban datën 24.12.2024, ndërsa ankimi kushtetues është paraqitur në datën 03.06.2025, pra në dukje jashtë afatit ligjor 4-mujor. Referuar komunikimit elektronik bashkëlidhur kërkesës, rezulton që vendimi t’i jetë njoftuar elektronikisht kërkuarit nga Gjykata e Lartë në datën 05.02.2025. Për sa më lart, rezulton se vendimi i arsyetuar i Gjykatës së Lartë është bërë i disponueshëm në datën 05.02.2025, e cila është edhe data nga e cila fillon afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Edhe

për sa i përket vendimit të Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit për kundërshtimin e vendimit nr.193, datë 23.05.2017 të gjykatës së apelit për sqarim dhe interpretim të vendimit nr. 1188 86-2017-1183, datë 23.03.2017 të kësaj gjykate dhe të atij që ka vendosur për kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit, Kolegji vëren se kërkuari legjitimohet *ratione temporis*, pasi ato i janë dërguar elektronikisht nga Gjykata e Lartë në datat 25.02.2025 dhe 20.02.2025. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, ndaj kërkuari legjitimohet *ratione temporis*.

31. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuari në objektin e ankimit kushtetues individual ka kundërshtuar gjithsej tre procese gjyqësore: (i) vendimet nr.7757, datë 26.12.2014, nr. 1188 86-2017-1183, datë 23.03.2017 dhe nr. 00-2024-5304, datë 24.12.2024, që kanë vendosur për themelin e padisë së tij për pavlefshmëri absolute të aktit administrativ; (ii) vendimet gjyqësore që kanë vendosur për kërkesën e tij për interpretimin e vendimit nr. 1188 86-2017-1183), datë 23.03.2017 të Gjykatës së Apelit dhe (iii) vendimin e Gjykatës së Lartë që ka vendosur për kërkesën për përjashtimin e Kolegjit Administrativ nga gjykimi i çështjes për interpretim. Lidhur me këto vendime, Kolegji vëren se kërkuari ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe të standardit të arsyetimit të vendimit, si dhe e drejta për dëmshpërblim. Në kushtet kur proceset gjyqësore të iniciuara nga kërkuari janë të ndërlidhura mes tyre, Kolegji çmon t'i analizojë ato së bashku. Në këtë kuptim, për sa i përket pretendimit për të drejtën për dëmshpërblim për dëmin moral e material, që përbën edhe një nga kërkimet e kërkesëpadisë së tij, nisur nga thelbi i tij, i cili ka të bëjë me arsyetimin e gjykatave të cilat kanë rrëzuar pretendimin e tij për dëmshpërblim, duke keqinterpretuar dhe moszbatuar kuadrin ligjor dhe vendimet e gjykatave, do të analizohet në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit. Për sa u përket pretendimeve të kërkuarit për të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, të cilat *prima facie* janë me natyrë kushtetuese, Kolegji vlerëson t'i analizojë në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme

32. Kërkuari ka pretenduar se i është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi kryetari i Gjykatës së Lartë ka refuzuar kërkesën për vetëpërjashtim të gjyqtarës E.M.(S), e cila ka marrë pjesë në vendimmarrje diametralisht të kundërta, sikurse vendimi nr.106,

datë 07.02.2023 i Gjykatës Administrative të Apelit që ka shfuqizuar certifikatën e pronësisë për trashëgimtarët e ish-pronarit Xh.K. të datës 20.04.2010, të lëshuar nga ASHK-ja, ndërkohë që me vendimet nr. 00-2024-5304, datë 24.12.2024 dhe nr. 00-2025-281, datë 30.01.2025 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i vlerëson të ligjshme veprimet e ASHK-së.

33. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se me vendimin nr. 00-2025-241, datë 30.01.2025 gjyqtari i vetëm, në emër të Kolegjit Administrativ, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e Kolegjit Administrativ të përbërë nga gjyqtarët E.M. (S), A.A. dhe G.M., të shortuar për gjykimin e çështjes me objekt: “Ndreqje gabimi, plotësim vendimi dhe sqarim e interpretim të vendimit nr.1188, datë 23.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit.

34. Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e paanshme. E drejta për një gjykatë të paanshme nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t’u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Po kështu, Gjykata ka pohuar se respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshëm i bazuar (*shih vendimin nr. 49, datë 16.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Duke iu kthyer rastit konkret, lidhur me argumentin e parë të pretendimit të kërkuarit se kryetari i Gjykatës së Lartë ka refuzuar kërkesën për vetëpërfshirje të gjyqtarës E.M.(S), Kolegji vëren se në datën 25.10.2024 gjyqtarja E.M.(S), ka bërë kërkesë për heqje dorë nga gjykimi i çështjes së themelit me objekt shpërblimin e dëmit, me arsyetimin se kishte shfaqur mendim për veprimtarinë e paligjshme të ASHK-së lidhur me zbatimin e gabuar të vendimit nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Me vendimin nr. 461, datë 04.11.2024, kryetari i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës me arsyetimin se nuk konstatohet shfaqje e njëanshmërisë së saj, pasi çështja për të cilën kishte dhënë mendim nuk lidhej me çështjen e dëmshpërblimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur ankimit kushtetues, gjyqtarja E.M.(S), në cilësinë e gjyqtarës në Gjykatën Administrative të Apelit, me vendimin nr.106, datë 07.02.2023, ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë që ka konstatuar pavlefshmërinë e veprimit administrativ të ZVRPP-së, Tiranë për lëshimin e certifikatës së pronësisë së datës 20.04.2010 në emër të trashëgimtarëve të ish-pronarit Xh.K., në tejkalim të kompetencave të parashikuara me ligj, si dhe shfuqizimin e veprimeve administrative të ZVRPP-së për ndarjen e sipërfaqes së përgjithshme të truallit në dy sipërfaqe dhe konstatimin e paligjshmërisë për lëshimin e certifikatave të pronësisë, pra duke dhënë një vendim në favor të kërkuarit. Në vijim, me vendimin nr. 00-2024-5304, datë 24.12.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit ndaj vendimit nr. 1188 (86-2017-1183), datë 23.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit për çështjen e themelit me objekt shpërblimin e dëmit moral dhe material nga ZVRPP-ja, Tiranë dhe ZQRPP-ja, me arsyetimin se pretendimeve u ishte dhënë përgjigje përfundimtare nga Gjykata Administrative e Apelit, si dhe në rekurs ishin ngritur çështje të vlerësimit të provave dhe fakteve të cilat dëlnin jashtë juridiksionit rishikues dhe ligjor të Gjykatës së Lartë.

37. Në analizë të standardeve kushtetuese të lartpërmendura dhe kontekstit të rrethanave të çështjes, si dhe nisur nga natyra e pretendimit të kërkuarit, Kolegji vlerëson se respektimi i parimit të paanshmërisë në gjykimin e çështjes së kërkuarit duhet të shqyrtohet në këndvështrim të testit objektiv, pra nëse ekzistojnë fakte bindëse të cilat ngjallin dyshim legjitim për njëanshmërinë e gjyqtarës gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë ndaj kërkesës së gjyqtarës për heqje dorë nga gjykimi nuk duket të jetë haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar në këndvështrimin kushtetues. Gjykata e Lartë ka sqaruar arsytet e refuzimit të kësaj kërkesë, pasi ka verifikuar pretendimet e gjyqtarës në drejtim të pozicionimit të saj gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatën e apelit. Po kështu, Gjykata e

Lartë ka vlerësuar se neni 72, pika 4, i Kodit të Procedurës Civile parashikon si rast përjashtimi kur gjyqtari ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim, duke iu referuar veprimtarisë jashtëgjyqësore të gjyqtarit, por edhe veprimtarisë gjyqësore kur gjyqtarit i vjen për gjykim e njëjta çështje që ka gjykuar më parë. Për sa më lart, fakti që kjo gjyqtare ka pasur njohuri të hollësishme për çështjen dhe ecurinë e procesit gjyqësor në apel, në të cilin ka dhënë një vendim në favor të kërkuarit, nuk passjell detyrimisht paragjykimin e saj çështjen, në veçanti në procedurën e gjyimit në trup gjykues në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, paanshmëria objektive e gjyqtarës në Gjykatën e Lartë nuk lë shkas për dyshime, pra dyshimi i kërkuarit për njëanshmërinë e saj nuk mund të konsiderohet mjaftueshmërisht i bazuar për të vënë në diskutim vendimmarrjen e asaj gjykate.

38. Lidhur me argumentin e dytë të pretendimit të kërkuarit, që konsiston në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës së Lartë në datën 29.01.2025 për përjashtimin e gjyqtarëve E.M. (S), A.A. dhe G.M. nga trupi gjykues i shortuar për gjykimin e çështjes me objekt: “Ndreqje gabimi, plotësim vendimi dhe sqarim e interpretim të vendimit nr.1188, datë 23.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit”, për shkak se me vendimmarrjen e datës 24.12.2024, ata kanë shkelur vendimin e formës së prerë nr.106, datë 07.02.2023 lidhur me veprimet e paligjshme të ZVRPP-së dhe ZQRPP-së, Kolegji vëren se me vendimin nr. 00-2024-5304 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka disponuar me mospranim për çështjen e themelit për shpërblimin e dëmit moral e material, ndërkohë që me vendimin nr. 00-2025-241, datë 30.01.2025 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka rrëzuar kërkesën e cila në objekt ka ndreqjen e gabimit, plotësimin e vendimit, sqarimin dhe interpretimin e vendimit nr.1188, datë 23.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit.

39. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se në analizë të standardeve kushtetuese të lartpërmendura, si dhe nisur nga natyra e çështjes për të cilën është kërkuar përjashtimi i trupës së gjyqtarëve të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, dyshimi i kërkuarit për njëanshmërinë e saj nuk mund të konsiderohet mjaftueshmërisht i bazuar për të vënë në diskutim vendimmarrjen e asaj gjykate.

40. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

41. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e faktit dhe Kolegji Administrativ nuk kanë paraqitur në arsyetimin e tyre një ligj tjetër material që të ketë ndryshuar UKM nr. 3, datë 21.06.1993, dalë në zbatim të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", sipas të cilit kur vlera e ndryshimeve del 20-50 %, diferenca mbi 20% paguhet nga ish-pronari brenda 1 viti, në të kundërt objekti mbetet në bashkëpronësi, ndërkohë që ish-pronari nuk ka paguar brenda një viti detyrimin për shtesat anësore të banesës ose vendime gjyqësore të mëparshme, të cilat të kenë rrëzuar vendimin nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, lënë në fuqi nga vendimi nr. 489, datë 26.03.1998 i Gjykatës së Kasacionit, lënë në fuqi nga vendimi nr. S-17, datë 09.02.2000 i Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë, lënë në fuqi nga vendimi nr. 76/2000 i Gjykatës Kushtetuese, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 38/2000, për të cilat ka dalë vendimi i urdhrit të ekzekutimit nr. 2024 akti, datë 20.11.2007 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas kërkuesit, Gjykata e shkallës së parë e ka konsideruar të njëjtë padinë e ngritur për pavlefshmërinë absolute të certifikatës së pronësisë dhe shpërblimin e dëmit në këtë gjykim me padinë për pavlefshmëri relative të ngritur në një gjykim tjetër, duke sjellë si pasojë pushimin e kërkesave të kërkuesit për pavlefshmëri absolute, si dhe ka lënë pa shkak ligjor kërkimin e tretë të padisë duke hequr konstatimin e veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme të ASHK-së. Ndërkohë, sipas kërkuesit, gjykata e apelit nuk përmend në arsyetimin e saj kërkimet e tjera të padisë për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të certifikatës së pronësisë të paraqitur nga kërkuesi në nisje të procesit gjyqësor. Kërkuesi ka pretenduar se kryetari i Gjykatës së Lartë nuk u ka kthyer përgjigje kërkesave të tij të datave 11.09.2023 dhe 28.09.2024 për bashkimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë në mbrojtje të vendimit nr. 76/2000 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe nuk ka marrë përgjigje as për kërkesën e datës 19.11.2024 me të cilën i është drejtuar trupit gjykues të Gjykatës së Lartë. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se për shkak të veprimeve të padrejta të gjykatave nuk ka marrë dëmshpërblim.

42. Gjykata është shprehur se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet

të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

43. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e saj është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar se vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar është vënë në lëvizje nga S.R. dhe trashëgimtarët e tij përfshirë edhe kërkuesin, të cilët kanë ngritur një padi me objekt: “(i) pavlefshmëri absolute e aktit administrativ, certifikatë vërtetim pronësie e datës 20.04.2010, lëshuar nga ZVRPP-ja, Tiranë, në kundërshtim flagrant me ligjin, me vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe me urdhrin e Zyrës Përmbartimore Tiranë; (ii) detyrimin e ZVRPP-së, Tiranë dhe ZQRPP-së, Tiranë të shpallin absolutisht të pavlefshëm dhe të fshijnë nga regjistri hipotekar regjistrimin e paligjshëm të pasurisë në emër të trashëgimtarëve të ish-pronarit Xh.K; ZVRPP-ja, Tiranë dhe ZQRPP-ja të shpallin absolutisht të pavlefshme certifikatën e datës

20.04.2010, të bëjnë regjistrimin e pasurisë, të pjesës në bashkëpronësi, në raportet 37% në emër të S.R. dhe familjarëve të tij dhe 63% në emër të trashëgimtarëve të ish-pronarit Xh.K; të lëshojnë certifikatë për vërtetim pronësie për bashkëpronësinë, në bazë të vendimit nr. 314/1994 të KKKP-së, Tiranë, që përbën urdhër ekzekutiv drejtpërdrejt të regjistrueshëm në ZVRPP-në, Tiranë, pika e dytë e të cilit u ndryshua me vendimin e formës së prerë nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; (iii) detyrimi i ZVRPP-së, Tiranë dhe ZQRPP-së të shpërblejnë dëmin moral në shumën minimale 5.000.000 lekë për secilin nga 6 anëtarët e familjes së S.R., dhe dëmin material, ku të përfshihen qiratë e 3 vjetëve të banesës aktuale në të cilën banon familja Roqi, në shumën 900.000 lekë, fitimi i munguar dhe kamatëvonesat”.

46. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin e datës 16.12.2014, ka vendosur pushimin për dy kërkimet e para të objektit të padisë, me arsyetimin se bazuar në nenin 58 të KPC-së këto kërkime kanë të njëjtin objekt, palë ndërgjyqëse e shkak me objektin e vendimit nr. 9393, datë 23.09.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, regjistruar në datën 26.10.2012, pra më parë se çështja në gjykim e regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në datën 01.09.2014. Lidhur me kërkimin e tretë të padisë, gjykata e shkallës së parë, me vendimin nr. 7757, datë 26.12.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, si të pabazuar në ligj dhe në prova, me arsyetimin se pala e paditur, ZVRPP-ja, Tiranë, nuk ka tagër dhe kompetencë të shfuqizojë vendimin nr. 314/1994 të KKKP-së, Tiranë, i cili është gjetur i ligjshëm me vendimin nr. 8996, datë 03.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin e formës së prerë nr. 2610, datë 10.12.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Sipas gjykatës së shkallës së parë i padituri nuk është organ që njeh ose përcakton pjesët takuese të pronësisë, por është ngarkuar nga ligji për regjistrimin e pjesëve takuese të pronësisë, siç pasqyrohen në titujt e pronësisë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim S.R. dhe trashëgimtarët e tij.

47. Për ankimin e S.R. dhe trashëgimlënësve Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1188 (86-2017-1183), datë 23.03.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë, me arsyetimin se është rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor të zhvilluar në respektim të dispozitave procedurale dhe është marrë në zbatim të drejtë të ligjit material në raport me faktet dhe provat objekt gjykimi. Gjykata e apelit fillimisht ka rrëzuar kërkesat e S.R. dhe trashëgimlënësve për bashkimin e çështjes në gjykim me dy çështje të tjera të paditësve në shqyrtim para asaj gjykate, me arsyetimin se nuk ka të bëjë me të njëjtat palë ndërgjyqëse, si dhe për shkak të kompleksitetit që do të sillte bashkimi i tyre. Po kështu, gjykata e apelit ka rrëzuar

kërkesën e S.R. dhe trashëgimlënësve për pezullim të procesit deri sa një nga çështjet me të cilën kërkohej bashkimi të merrte formë të prerë, me arsyetimin se çështja objekt shqyrtimi mund të zgjidhet edhe pa u zgjidhur me vendim të formës së prerë çështja tjetër. Lidhur me objektin e padisë, ajo gjykatë ka vlerësuar se paditësit (S.R. dhe trashëgimtarët e tij, përfshirë edhe kërkuesin) nuk i kanë paraqitur ZVRPP-së, Tiranë asnjë akt që të përbënte titull pronësie sipas nenit 193 të KC-së, e në këto kushte ajo nuk mund të vepronte me nismën e saj për regjistrim, ndërkohë që paditësit duhet të kundërshtojnin aktin e fitimit të pronësisë të trashëgimtarëve Kadesha, specifikisht pikën 1 të vendimit nr. 314/1994 të KKKP-së, Tiranë e më pas të kërkonin regjistrimin e pjesës takuese. Sipas gjykatës së apelit, bazuar në nenin 3 të ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësitë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, nuk ka rezultuar që ZVRPP-ja, Tiranë gjatë ushtrimit të funksionit publik të ketë kryer ndonjë veprim ose mosveprim të kundërligjshëm që t’u ketë shkaktuar dëm moral paditësve. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs S.R. dhe trashëgimtarët e tij.

48. Pas përfundimit të procesit gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 12.04.2017, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë për sqarim, interpretim, ndreqje gabimesh dhe plotësim të vendimit nr. 1188 (86-2017-1183), datë 23.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit në pjesën hyrëse dhe në arsyetimin e tij. Me vendimin nr. 193, datë 23.05.2017, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur pranimin e pjesërisht të kërkesës për ndreqje gabimesh dhe pasaktësish dhe rrëzimin për kërkimet e tjera të padisë. Kundër këtij vendimi, në datën 11.09.2017 kanë paraqitur rekurs S.R. dhe trashëgimtarët e tij. Me vendimin nr. 00-2025-281, datë 30.01.2025, Kolegji Administrativ Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit për sqarim, interpretim, ndreqje gabimesh dhe plotësim të vendimit nr. 1188 (86-2017-1183), datë 23.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit.

49. Ndërkohë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-5304, datë 24.12.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit ndaj vendimit nr. 1188 86-2017-1183, datë 23.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, pretendimeve u është dhënë përgjigje përfundimtare nga Gjykata Administrative e Apelit, si dhe në rekurs ngrihen çështje të vlerësimit të provave dhe fakteve, të cilat dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ligjor të Gjykatës së Lartë. Për pretendimet e ngritura rishtazi nga kërkuesi pas depozitimit të rekursit, Gjykata e Lartë është shprehur se gjendet në kushtet e ndalimit ligjor për shqyrtimin e tyre, ndërsa për pretendimin e

kërkuesit për mospasqyrim të palës së paditur ZQRPP-së në përmbajtje të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykata e Lartë, ndonëse e ka vlerësuar të drejtë, ka arsyetuar se nuk përbën shkak sipas ligjit për cenim të tij, pasi nuk ka sjellë asnjë pasojë për të drejtat e kërkuesit.

50. Nga sa më lart, Kolegji vlerëson se referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore objekt kërkesë, ato i përmbushin elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Vendimet përmbajnë të dhënat e palëve, shkaqet e parashtruara në ankimin/rekurs, vendimet e gjykatave më të ulëta, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku kanë mbështetur qëndrimin e shprehur në diapozitiv. Gjykatat e faktit kanë rrëzuar padinë e kërkuesit, duke arsyetuar vendimin e tyre në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, ndërsa Gjykata e Lartë, pavarësisht se me arsyetim të kufizuar, ka evidentuar shkaqet e ngritura në rekursin e kërkuesit, sikundër edhe vlerësimin e saj për sa u përket kritereve të pranueshmërisë së tij për shqyrtim. Gjykata Administrative e Apelit në vendimin e sqarimit dhe interpretimit të vendimit të saj, pasi ka pranuar ndreqjen e gabimeve dhe pasaktësive, ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në kërkesë mund të parashtrohen në rekurs, pasi në thelb kanë të bëjnë me mënyrën sesi gjykata e ka zgjidhur çështjen me vendim përfundimtar dhe sesi ajo e ka vlerësuar atë. Gjykata e Lartë në vendimin e sqarimit dhe interpretimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit ka vlerësuar se nuk konstatohen paqartësi, mangësi ose pasaktësi të dukshme të vendimit. Vendimet nuk rezultojnë të jenë alogjike, kontradiktore ose të paqarta në përmbajtjen dhe vlerësimin e tyre. Për sa kohë nga kërkuesi nuk argumentohet se zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës, vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor, në të cilin palët kanë pasur mundësinë të ushtrojnë garancitë e tyre procedurale, gjykatat kanë dhënë një vendim jo në favor të tij, nuk është i mjaftueshëm për të provuar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

51. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

52. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.